



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/261

Datë: 05.07.2018

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika c, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 23 dhe 37 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dispozitave të Ligjit nr.03/L-182 për mbrojtjen nga dhuna në familje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.76/10 Gusht 2010), nenit 19 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur me datë: 03.07.2018 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen Rekomandimet për barazinë Gjinore të propozuara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi rekomandimet e miratuar janë si në vijim;
 - 2.1. Të formohet Komiteti për barazi gjinore, si trup e Kuvendit Komunal prej 7 anëtarësh, 5 anëtar nga Kuvendi Komunal, zyrtarja për barazi gjinore dhe një nga shoqëria civile.
 - 2.2. Komiteti për barazi gjinore pas themelimit, të bëjë hartimin e planit të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe të hartojë një strategji si duhet qasur problemeve tjera të pabarazisë gjinore brenda dhe jashtë institucioneve komunale në Malishevë.
 - 2.3. Të fuqizohet mekanizmi për koordinim në Komunën e Malishevës mbi dhunën në familje, me qëllim që të përmirësohet koordinimi midis institucioneve përkatëse dhe të ofrohet një qasje e përmirësuar për raportim nga Njësia për të drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
 - 2.4. Të kërkohen burime shtesë financiare nga buxheti i Komunës dhe nga donatorët për të financuar projektet e zyrës për barazi gjinore dhe për të siguruar mbrojtje sociale për viktimat e dhunës, si dhe për aktivitetet tjera që lidhen me projektet e barazisë gjinore.
 - 2.5. Raportimi në baza të rregullta në KKSB të rasteve të dhunës në familje dhe jashtë saj.
 - 2.6. Komiteti për barazi gjinore së bashku me QPS-në dhe institucionet tjera të përgatisin raport ku raportojnë të paktën një herë në vit në Kuvendin Komunal, për gjitha rastet e dhunës dhe për të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.



- 2.7. Në raportimin e komandantit të PK të Malishevës të raportohet edhe për dhunën në familje dhe në institucionet tjera në kuadër të Komunës.
- 2.8. Të shtohet vëmendja e institucioneve relevante lokale dhe të parandalohen rastet e dhunës si në familje, komunitet dhe në institucione.
- 2.9. Të shtohet përkrahja nga qeveria komunale për organizatat joqeveritare që merren me projektet për fuqizimin e rolit të gruas.
- 2.10. Të organizohen aktivitete të ngjashme si ajo e javës së gruas.
- 2.11. Të ndahen nga 100€ (njëqind euro) për nënat me fëmijë të porsalindur. Mjetet për këtë vit të ndahen nga rishikimi buxhetor, kurse për vitin e ardhshëm të planifikohen dhe përfshihen në buxhetin Komunal.
- 2.12. Institucionet relevante lokale të rrisin inspektimin dhe mbikëqyrjen e respektimit të drejtave të punëtorëve në sektorin privat me fokus shkeljet që kanë prapavije gjinore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, buxhet dhe Financa dhe Komitetit për barazi gjinore në Komunën e Malishevës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina